



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017 Ref.: 636117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.572/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji Dardania për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.583/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.583/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të Kolegjit Dardania:
 - Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS; dhe
 - Administrim Biznesi dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve në programet e cekura në piken dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.583/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji Dardania me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 583/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim Kolegjit Dardania i është pezulluar akreditimi për programe të studimit: Psikologji Organizative, MA, 120 ECTS; Arkitekturë dhe Planifikim Urban, BA, 180 ECTS; Administrim Biznesi dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS; Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS; Administrim Biznesi dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS, (vendimi nr. 1249/16, datë 07/11/2016); Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS, dhe Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, , BA, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji Dardania, është konstatuar që programet e cekura në pikën dy (2) të këtij vendimi, i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Sipas kësaj pike, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) duhet të ketë të paktën tre persona në marrëdhënie të rregullt pune të nivelit PhD për secilin program të studimit.

Për programet e tjera të pezulluara me vendim (nr.583/17, datë 06.07.2017), KSHC ka konstatuar që këto programe nuk i përmbushin kushtet sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Dardania";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

